

VENDIM
Nr. 156, datë 19.3.2014

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 804, DATË 21.11.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË PERSONELIT TË POLICISË SË SHTETIT”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 41, 49, 52, 86 dhe 129, të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit” të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në nenin 26 të rregullores së personelit të Policisë së Shtetit, miratuar me vendimin nr. 804, datë 21.11.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas pikës 5 shtohen pikat 6 dhe 7, me këtë përmbajtje:

“6. Ministri i Punëve të Brendshme, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, pranon në polici aplikantë nga radhët e fëmijëve të punonjësve të policisë, të cilët kanë humbur jetën në krye apo për shkak të detyrës.

7. Aplikanti pranohet në polici pasi të ketë plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 6, të ketë paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në nenin 7 dhe t’i jetë nënshtruar procedurës së testimit sipas shkronjave “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe “e” të nenit 13 të kësaj rregulloreje.

2. Ngarkohet ministri i Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama